

VENDIM
Nr.639, datë 20.9.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.445, DATË 26.6.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR INSPEKTIMIN E PUNËS SË DETARËVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 28 të ligjit nr.7986, datë 13.9.1995 “Për Inspektoratin Shtetëror të Punës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.445, datë 26.6.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon: “6. Personat, juridikë a fizikë, të përcaktuar sipas pikës 2 të këtij vendimi, në dokumentacionin që depozitojnë në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për t’u licencuar apo rilicencuar duhet të kenë edhe dokumentin e regjistrimit në Inspektoratin Shtetëror të Punës të rrethit përkatës.”.

2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7. Ngarkohen Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Brendshëm për nxjerrjen e udhëzimit përkatës për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha